



N j o f t i m P u b l i k

Në Komunën e Prishtinës është dorëzuar kërkesa 05 nr.350/02-108720/25 dt.25.07.2025, në emër të kërkuësve: Blerim Gashi, Naim Gashi, Veli Isufi, Qefserë Musa, Alban Muja Ramadan Hyseni etj. nga Prishtina dhe me Investitor “Mana” sh.p.k. nga Prishtina me certifikatën e biznesit ARBK 810833493 me pronar Artan Dreshaj, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit kryesor për ndërtimin e ndërtesës shumë banesore & afariste - **“Kompleksi Mana”** me 2B+S+ P+14, në kuadër të Blloku “3” të Planit Rregullues “Kalabria” 2024 – 2032 në Prishtinë, konkretisht parcelave **nr.7603-2, 3, 4, 5, 6, 35 & 56; nr.7598-6, 8, 9 & 10; nr.7599-1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 & 11** ZK Prishtine, sipas projekt propozimit / Planit të situacionit - “zgjidhjes urbane” të prezantuar, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data **02.09.2025** deri më **15.09.2025**, në e-mail adresën: **urbanizmprihtine@rks-gov.net**.

Kushtet e propozuara të ndërtimit - “Kompleksi Mana” me 2B+S+P+14	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës:	Tokë bujqësore / Tokë ndërtimore
b. Vija rregulluese	Sipas planit rregullues
c. Vija ndërtimore	Sipas planit rregullues
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	7.5 / 46.00m’ - Ana lindore 7.5 / 31.00m’ - Ana perëndimore
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësor dhe të pasmë të parcelës kadastrale	7.5 / 46.00m’ & 31.00 m’ - Ana jugore 7.5 / 46.00m’ & 31.00 m’ - Ana veriore
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHP=36.2 % - 2914.3m ²
g. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHGJ=40 % parter % + 10% kulmi
i. Përqindja e sipërfaqes bruto ndërtuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISPN=3.0 – 24,112.20m ²
j. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHPN=67.2% - 5,360.1m ² , propozuar
k. Numri i hapësirave për vend parkime të automjeteve në kuadër të parcelës	268 VP, në objekt + 0 VP, në parter
l. E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese	Po
m. Materialet në sipërfaqet e jashtme të ndërtesave të reja	Fasadë ventiluese
n. A ka qasje të pakufizuara në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po ☒ Jo ☐ Nuk aplikohet ☐	
o. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë me të madhe se sa zona për rreth? Po ☐ Jo ☒ Nuk aplikohet ☐ Sqaro:	
p. A është ndonjë nga punët ndërtimore në Zona të Mbrojtura, Zona të Veçanta, ose Zona të Veçanta të Mbrojtura? Po ☐ Jo ☒ Nuk aplikohet ☐ Sqaro:	

Në bazë të Udhëzimit Administrativ të MMPH Nr. 06/2017, dt. 23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimimi për kategorinë I dhe II të ndërtimeve, nën 13. paragrafët 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në ueb-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigja njëherësh do të publikohet në ueb-faqe të Komunës.

Në të gjitha komentet që përcillen në adresën elektronike, të shënuar më lartë, të përshkruhet edhe numri i kërkesës, i shënuar në paragrafin 1 të këtij njoftimi publik.

Zyrtari: _____